

RREGULLORES
TAHIRI

PROPOZIM

Në bazë të nenit 15, të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14, e zbatueshme sipas Rregullores së PSSP të K.B. nr. 2003/30, dhe të nenit 3 nën (b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës e të nenit 19, alineja 1, pika 2, dhe të nenit 39 alineja 7 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e vet të mbajtur më _____ 2006 morri këtë:

PROPOZIMVENDIM

Për miratimin e Planit Rregullues Urban "Tabakhane" pjesë e lokacionit "Qendra e Re" të qytetit të Prizrenit

Neni 1

Me këtë Vendim bëhet miratimi i PRrU-së "Tabakhane" pjesë e lokacionit "Qendra e Re" të qytetit të Prizrenit, e cila ofrohet si donacion nga NPPT "Renelual Tahiri" nga Prizreni, hartuar nga NTSH Studio projektuese "Diarko" nga Prizreni (bartës i hartimit të planit) e hartuar në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Prizrenit.

Pjesë përbërëse e këtij Drafti të PRrU-së do të jetë elaborati me të gjitha shtojcat grafike dhe tekstuale.

Pjesa tekstuale përmbanë:

- kushtet për rregullimin dhe destinimin e ndërtimit në këtë hapësirë.

Pjesa grafike duhet të përmbajë:

- paraqitjen grafike të Planit Rregullues Urban.

Neni 2

Me Planin Rregullues Urban "Tabakhane" pjesë e lokacionit "Qendra e Re" të qytetit të Prizrenit përfshihet ngastra kadastrale: nr. 2651 gjithësejtë në sipërfaqe prej S = 51 ari.

Me Planin Zhvillimor Urban është e definuar për këtë lokacion ndërtim të administratës, tregëti, hoteleri dhe banim kolektiv.

Neni 3

Planit Rregullues Urban – "Tabakhane" pjesë e lokacionit "Qendra e Re", përfshin lokacionin e ish depove të NT "Liria", respektivisht pjesën perendimore të bërthamës së qytetit dhe përkufizohet:

- Me kufirin e rrugës "Ibrahim Lutfiu në Jug.
- Me kufirin e rrugës "Mbreti Piro" në veri dhe lindje.
- Me një shirit të parcelave private në perendim cila pastaj kufizohet me hekurudhën e qytetit dhe ma tutje me zonën ekzistuese industriale.

Neni 4

Me Planin nga neni 1 i këtij Vendimi do të planifikohet zgjidhja e hapësirës në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale për zhvillimin e ardhshëm të Prizrenit, me qëllim që t'ju mundësojë qytetarëve jetën në një lokacion me planifikim urban.

Neni 5

Plani Rregullues Urban hartohet për periudhën kohore më së paku 5 (pesë) vjeçare.

Neni 6

Ky Vendim bashkë me dokumentacionin e përshkruar në nenin 1. alineja 2 të këtij Vendimi do të jetë pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe i njëjti do të shpallet në "Kumtar".

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Asambleja Komunale

Nr: 01/011-49

Më: 28.09 2006

Prizren

Kryetari i Kuvendit
Mr. Eqrem Kryeziu